



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës/Direkcija za Obrazovanju i Kulturu

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, dhe duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën E Kosovës Nr. 04/L-32 si dhe në Udhëzimet Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS

**PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË SHKOLLËS
PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2019/2020**

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë(10) në Shkollën e Mesme Ekonomike për vitin shkollor 2019/20.

Nr.	Shkolla	Nr.i paraleleve	Nr. i nxënësve	Lëmia dhe profili	Gjithsej
1	Shkolla e Mesme Ekonomike	1	35	Ekonomi Kontabilitet	35
2	Shkolla e Mesme Ekonomike	1	35	Ekonomi Tregtarë me pakicë dhe shumicë	35
Totali		2	70		70

Konkursi shpallet me këto kushte dhe kriteret:

Kushtet e regjistrimit:

Për regjistrim nxënësve në klasën e 10-të, në Shkollën e Mesme Ekonomike për vitin shkollor 2019/20, mund të konkurojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9^e të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në Shkollën e Mesme Ekonomike në Bostan duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollë)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën (ekstraktin) e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për vitin shkollor 2019/2020, bëhet më datën **24, 25 dhe 26 qershor 2019** në lokalet e shkollës duke filluar nga **ora 8:00-16:00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen me datën **28 .06.2019**.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **28.06.2019**.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 25 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\frac{\text{Suksesi}(kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)}{4} \times 5 = 25$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë (p.sh 2 lëndë të profilit të caktuar shumëzohet më mesataren e notave të kl. 6 - 9 të $(5+5+5+5) = 20$; $20 : 4 = 5$)

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I)} + \text{mesatarja e lëndës (II)}}{2} \times 3 = 15 \text{ pikë max}$$

3. Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në shkolla profesionale

Ekonomi

1. Matematikë dhe informatikë $25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze $25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Shkenca shoqërore $25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkencat natyrore $25 \times 0.2 = 5$ pikë

Në Novobërdë
Më, 24.06.2019



Drejtoresha e DAK-ut
Jordanka Dordevic